



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201300987/32

Tiranë ___/___/2016

Lënda: *Rekomandohet dhënia e mendimeve nga ISSH për projektvendimin për ndryshimin e VKM Nr.190, datë 03.05.1995 'Për Statusin e LANÇ-it'*

Drejtuar: **Instituti të Sigurimeve Shoqërore**
Drejtorit të Përgjithshëm
Z. Astrit HADO

TIRANË

I nderuar Z. Hado,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë paraqitur ankesë disa qytetarëve, të cilët pretendojnë se nuk po zbatohen vendimet e gjykatës që detyrojnë Ministrinë e Mbrojtjes t'i njoh statusin e veteranit të Luftës Nacional Çlirimtare si dhe të rivendosë në afat të drejtën e tyre për të paraqitur kërkesën për ta fituar këtë status. Arsyeja e moszbatimit të këtyre vendimeve gjyqësore është se, Komisionit Qëndror të Statusit të Veteranit të LANÇ i ka mbaruar afati i veprimtarisë i caktuar në VKM-ën Nr. 190, datë 03.05.1995.

Moszbatimi i vendimeve të gjykatës është gjykuar nga ana jonë si shkelje e ligjit dhe për këtë arsye i kemi rekomanduar Kryeministrisë ndryshimin e VKM Nr.190, datë 03.05.1995 duke parashikuar që, Komisioni Qëndror i Statusit të Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe stafi teknik i tij të funksionojë për çdo rast që ka detyrimin të veprojë për të zbatuar një vendim të gjykatës të formës së prerë.

Në përgjigje të këtij rekomandimi, Kryeministria na ka përcjellë për dijeni shkresën drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes ku, kësaj të fundit i kërkohet gjetja e një zgjidhje për zbatimin e vendimeve të gjykatës për statusin e veteranit.

Ministria e Mbrojtjes na ka vënë në dijeni se ka hartuar projektvendimin për ndryshimin e VKM Nr.190, datë 03.05.1995. Meqenëse ky projektvendim ka efekte financiare, Ministria e Mbrojtjes ia ka dërguar atë për mendim edhe Instituti të Sigurimeve Shoqërore.

Pas interesimit tonë me anë të dy shkresave në ISSH jemi informuar se ende nuk është dhënë mendim lidhur me projektvendimin në fjalë.

Z. Hado, mosdhënia e mendimit për projektvendimin po zvarrit procedurën për miratimin e tij dhe për rrjedhojë edhe procedurën për zbatimin

e vendimeve të gjykatës. Duke besuar në vullnetin Tuaj për bashkëpunimin e frytshëm ndërmjet institucioneve po ju dërgojmë rekomandimin për dhënien e mendimit për projektvendimin për ndryshimin e VKM Nr.190, datë 03.05.1995.

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut" si dhe në mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive."

J U R E K O M A N D O J M Ë:

Dhënien e mendimit për projektvendimin për ndryshimin e VKM Nr.190, datë 03.05.1995 'Për Statusin e LANÇ-it' të hartuar nga Ministria e Mbrojtjes.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI